



Kanton Bern
Canton de Berne

hallo-bern.ch
salut-berne.ch

Kantoni i Bernit

Portret i shkurt

Sistemi politik

Feja

Koha e lirë

hallo-bern.ch

Informacione për një fillim të mirë në vendbanimin e ri
Kantoni i Bernit



Portret i shkurt

Kantoni i Bernit është njëri prej 26 kantoneve (shtet anëtarë) në Zvicër. Sipas numrit të banorëve është kantoni i dytë më i madh. Tipike për kantonin e Bernit është funksioni i tij urëlidhës në mes pjesëve të vendit me gjuhë gjermane dhe gjuhë frënge.

Numrat dhe faktet

Kantoni i Bernit ka një milion banorë dhe banorë, prej tyre janë gati 16 përqind shtetas të huaj. Sipërfaqja gati 6000 km² e kantonit përbëhet prej 346 komunave me banorë. (Gemeinden | Communes) dhe dhjetë rretheve administrative. Kryeqyteti është Berni. Gjuha zyrtare është gjermanishtja dhe frëngjishtja. Dy gjuhësia është diçka e veçantë, prandaj çmohet shumë.

Historia

Kantoni i Bernit e ka historinë mbi 800 vjet të vjetër. Qyteti i Bernit është themeluar më 1191. Qyteti u zgjerua pastaj shpejt. Më 1798 qyteti i vjetër i Bernit u pushtua nga revolucionarët e ushtrisë franceze. Prej 1831 filloi të zhvillohet demokracia. S`pari herë kishte drejtësi njëzëri me përpilimin e kushtetutës të re. Më 1848 u bë Beni kryeqytet i Zvicrës. Më 1979 kantoni Jura u formua me tri rajone dhe u nda nga kantoni i Bernit.

Rite dhe tradita

Në rajonet e ndryshme dhe komuna të kantonit ka tradita dhe rite të ndryshme. Një "unitet" për rite në kantonin e Bernit nuk ekziston. Në Emmental feston njeriu festa tjera e jo si në Berner Oberland, edhe këtu ka rite të tjera që dallojnë nga Berner Jura apo Mittelland. Secili rajon ka veçantit e veta. Kantoni i Bernit e mbanë një listë me tradicione që mbahen ende në jetë. Për këtë ka një makinë kërkuese speciale.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/kantoni-i-bernit/portret-i-shkurt



Sistemi politik

Fuqia politike në Zvicër është e ndarë në tri rrafshe: Federata, kantonet dhe komunat. Zviceranet dhe zviceranët mundën përmes votës të vendosin për vendimet politike.

Shteti konfederativ i Zvicrës

Shteti federativ i Zvicrës ekziston prej 1848. Kryeqyteti është Berni. Zvicra nuk përbën as etnikisht, as me gjuhë as me besim një unitet. Meqë kultura të ndryshme vullnetarisht janë bërë bashkë, flet njeriu për një nacionalitet dëshire ("Willensnation" | "Nation par volonté"). Zvicra në politikën internacionale është shet neutral.

Federata

Në Zvicër kanë kantonet dhe komunat një pavarësi të madhe. Kompetencat në politik dhe ligje janë të ndara në mes federatës, kantoneve dhe komunave. (Subsidiaritätsprinzip | principe de subsidiarité). Njeriu flet këtu për federatë (Föderalismus | Fédéralisme). Të 26 kantonet dhe mbi 2000 komuna kanë plotësisht të ndërtuara strukturat shtetërore. Kantoni i Bernit ka një kushtetutë dhe një qeveri të veten, një parlament dhe gjyqjet. Për shumë detyra shtetërore janë kantonet apo komunat përgjegjëse. Për këtë si shembull është sistemi shkollor prej kantoni në kanton i rregulluar ndryshe. Përgjatë ligjet shtetërore vlejné për gjithë Zvicrën, kantonet i kanë ligjet e veta, që vlejné vetëm për zonën kantonale. Edhe komunat mund t'i vëjnë rregullat e veta. Për përballimin e detyrave, kantonet dhe komunat si dhe federata kërkojnë tatimet.



Ndarja e pushteteve

Për pengimin e koncentrimin të pushtetit, është pushteti shtetëror në Zvicër dhe në kantone i ndarë në tri pushtete të pavarura: Pushteti legjislativ (pushteti legjislativ), ekzekutiv (pushteti ekzekutiv) dhe juridik (pushteti juridik). Në kantonin e Bernit zyrtarët i marrin këto detyra:

- Legjislativ: Këshilli i madh (160 anëtar, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet). Administrimi rajonal i pjesës ku flitet frëngjishtja Berner Jura i ka 12 ulëse të garantuara në këshillin e madh.
- Ekzekutiv: Këshilli qeverisës (7 anëtarë, të zgjedhur nga populli çdo katër vjet). Berner Jura e ka një ulëse të garantuar.
- Juridik: Gjyqje të ndryshme të rajonit dhe në rrafshin kantonial.

Edhe komunat kanë një legjislativ (mbledhje e komunës, apo parlament, dhe një ekzekutiv (këshill qyteti apo komune). Në rrafshin shtetëror legjislativi i ka dy dhoma: Nacional- dhe këshilli shtetëror. Pushteti nacional (7 anëtarë) quhet këshilli federativ. Edhe në rrafshin nacional ekzistojnë gjyqje të ndryshme. Në gjyqin federal si instanca më e lartë mund të dërgohen p.sh. vendimet gjyqësore të kantonit.

E drejta demokratike

Zviceranet dhe zviceranët e kanë të drejtën e votës dhe zgjedhjeve. Ata zgjedhin komitetet politike në komunë, kanton, federatë dhe munden edhe vet të kandidohen për zgjedhje. Përveq kësaj munden banoret dhe banorët me votën e tyre për detyra politike në komunë, kanton edhe në federatë të vendosin, demokracia direkte (direkte Demokratie | démocratie directe). Me incianiva të popullit munden banoret dhe banorët edhe kërkesat e tyre me të sjell për votim. Të huajat dhe të huajt që jetojnë në kantonin e Bernit, nuk kanë të drejtë vote. Mirëpo, ka mundësi të tjera me të angazhohet politikisht, dhe pikëpamjet t'i adresoni te zyrtarët: Antaresimi në një parti, në një organizatë apo shoqatë

- Bashkëpunim në komisione apo komitete tjera
- Peticione
- Përmes letrave të shkruara apo në forume në internet

Në disa komuna ka komitete për pjesëmarrjen e migrantëve dhe migrantëve. P.sh. forumi i migrantëve dhe migrantëve në qytetin e Bernit.



E drejta themelore

Të drejtat themelore më të larta në Zvicër janë të shkruara në kushtetutën federative (Bundesverfassung | Confédération). Një pjesë e rëndësishme e kushtetutës federative janë të drejtat themelore, të cilat bazohen në konventën evropiane për të drejtat e njeriut (EMRK | CEDH). Ato mbrojnë ekzistencën e njeriut (p.sh. e drejta për jetë, e drejta për ndihmë në situata emergjente) dhe mbrojnë individin kundër dhunës shtetërore apo grupet kundër shumicës. Të gjithë njerëzit janë, prej diskriminimit të prejardhjes, rases, besimit, gjinisë, drejtimit seksual, moshës, fesë si dhe kufizimit trupor, psikik, mendor të mbrojtur. Viktimat e diskriminimit racor marrin në kantonin e Bernit mbështetje dhe këshillim falas. Kush është i prekur prej diskriminimit, mundet të paraqitet në zyrën kontaktuese për integrim apo në zyrën profesionale (gggfon & RBS). Në Zvicër mbretëron liria e fesë, mendimit dhe shtypit.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/kantoni-i-bernit/sistemi-politik



Feja

Zvicra është tradicionalisht një vend i krishterë. Mirëpo sot jetojnë shumë njerzë të tjerë në Zvicër që kanë fe të tjera. Një pjesë e madhe e popullit zviceran nuk është në asnjë shoqëri fetare. Liria fetare është e garantuar dhe shkollat e shtetit janë kundrejt fesë neutrale.

Feja dhe shteti

Zvicra është tradicionalisht e karakterizuar me fenë e krishterë. Qëndron në përgjegjësin e kantoneve, që t`i përcaktojnë marrëdhëniet e fesë me shtet. Në shumicën e kantoneve gjermanozviceran, si dhe në kantonin e Bernit, shoqëria fetare e krishterë është e pranuar si institucion publik-juridik (Kishat shtetërore, Landeskirchen | églises nationales). Kjo do të thotë, që shteti atyre ju bart disa të drejta. Konkretisht munden kishat p.sh. prej pjestarëve të tyre të marrin tatim. Në kantonin e Bernit janë kishat römisch-katolike , ajo e reformuar dhe kishat kristkatolike si kisha shteti. Komunitatet eude në Bern dhe Biel më 1997 janë pranuar zyrtarisht.

Shoqërit fetare në kantonin e Bernit

Pranë shoqërive fetare (kishave shtetërore) zyrtarisht të pranuar ka në kantonin e Bernit edhe shoqëri tjera të shumta fetare me besime të ndryshme. Shumica e banoreve dhe banorëve të Bernit i takojnë besimit të krishterë. Në vitet e fundit është rritur edhe numri i muslimanëve. Gati një e katërta e banoreve dhe banorëve deklarohen se nuk i përkasin asnjë drejtimi fetar.

Liria fetare

Kushtetuta e Zvicrës garanton lirinë fetare. Secili ka të drejtë, ta ketë një besim fetar, këtë besim ta shpreh dhe ta përhap. Askush nuk mund të detyrohet, të hyj në një shoqëri fetare apo të marr pjesë në veprimet e tyre. Personat mund të mblidhen për me festue ritualet fetare. Askush nuk guxon të diskriminohet për shkak të fesë apo besimit të tij.



Feja dhe shkolla

Shkolla e detyruar është për nga feja neutrale. Kjo nuk do të thotë, që temat religjioze nuk kanë vend në mësim. Dallimi bëhet në mes dy llojeve të mësimit për religjionin. Mësimi për fenë i kishave shtetërore dhe mësimi shkollor për besimin "Etika, religjioni dhe shoqëria". Në këtë lëndë tematizohen pyetjet fetare dhe etike që u përkojnë tërë njerëzve. Pjesëmarrja në mësimin rrëfyes fetar në kishat shtetërore është vullnetare. Për fëmijët me besim tjetër ofrojnë shoqërit fetare pjesërisht mundësi për mësim fetar jashtë shkollës.

.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/kantoni-i-bernit/feja



Koha e lirë

Në kantonin e Bernit ka mundësi të shumta atraktive, me e kaluar kohën e lirë. Një rëndësi të madhe kanë shoqatat e shumta. Këto ofrojnë njëkohësisht mundësin me u njoftue me njerzë të tjerë.

Shoqatat

Shumë banore dhe banorë të kantonit Bernit janë anëtarë në një shoqatë (Verein | association). Ka shumë shoqata për interesa të ndryshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport-, kulturë dhe të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për me ra në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë për të gjithë personat të hapura. Informacione për shoqata, gjinden edhe në faqet e internetit të komunave.

Ofertat për fëmijë dhe të rinjë

Për të rinjët ka në kantonin e Bernit shumë oferta specifike, për ta kaluar kohën e lirë dhe me njoftë bashkëmoshatar. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjët janë nën përkujdesje, munden me i sjell idetët dhe me i zbatue projektet e tyre (puna e të rinjëve). Ofertat janë zakonisht falas. Shoqatat për të rinjë ofrojnë mundësin, që s`bashku me bashkëmoshatar të ndërmarrin aktivitete dhe të ushtrojnë sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Komuna jep njoftime të tjera.

Shëtitjet dhe kultura

Kantoni i Bernit ofronë mundësi të shumta për shëtitje dhe ofertë të pasur kulturore. Natyra është e karakterizuar prej qyteteve të vogëla, kështjellave, dhe shtëpitë e rahatshme të bujqëve. Përveç kësaj ka edhe shumë rrugë të bukura shtegëtimi- dhe për biçikleta. Një numër i madh i muzeve, ofrojnë ekspozita me tema të ndryshme. Në tërë Zvicrën janë të njohur p.sh. qendra Paul Klee apo muzeu i artit në Bern. Organizata për turizm në Bern "Made in Bern" informon për mundësit e shëtitjeve dhe ekspozitat. Informacionet për ekspozitat kulturore aktuale i gjenë njeriu edhe në gazetatat lokale.



Puna vullnetare

Puna vullnetare është një kontribut i shoqërisë për njerëzit dhe ambientin e cila nuk paguhet. Detyra të shumta merren tradicionalisht prej vullnetarëve. Një pjesë e madhe e punës bëhet në shoqata. Kështu mundet njeriu të angazhohet në shoqatat për kulturë, sport, interesa sociale, arsimim, për mbrojtjen e kafshëve dhe ambientit, shëndetësi dhe fusha të tjera. Informacione për punën vullnetare dhe mundësit e nevojshme japin zyrat për punë vullnetare Benevol, Karitasi në Bern apo kryqi i kuq zviceran (SRK | CRS) në kantonin e Bernit. Për vullnetar për detyra në fushën e azilit dhe refugjatëve, janë partnerët rajonal të kantonit përgjegjës. Andresat janë poshtë të linkuara. Më shumë informacione ndanë edhe kontakti me kishë për pyetje për refugjatë (KKF | OCA).

Sporti / Kultura / Arsimit

Në kantonin e Bernit ka shumë organizime në sport-, kultur dhe arsimim. Informacione për këtë merr njeriu në komunën e banimit apo në organizatat për turizëm. Me Kulturlegji- letërnjoftim të karitasit, kanë njerëzit me pak para, lirim për sport-kultur- dhe veprimtari arsimore. Për këtë letërnjoftim mund të bëhet kërkesa në karitas. Karitasi informohet dhe e vërteton a ka njeriu të drejtë të ketë Kulturlegji.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/kantoni-i-bernit/koha-e-lire